



**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**

## QERSHOR 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

## MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

### Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




[ankesa@amp.gov.al](mailto:ankesa@amp.gov.al)



0800 90 90

### Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



[denonco@amp.gov.al](mailto:denonco@amp.gov.al)



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë

### Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

### Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



[www.amp.gov.al](http://www.amp.gov.al)



## VEPRIME HETIMORE

### Referimet e bëra në Prokurori

**27** referime në Prokurori për **28** punonjës të Policisë së Shtetit, **1** punonjës i P.M.N.Z.SH dhe **3** shtetas, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

### Arrestuar/ndaluar në flagrancë

**2** punonjës policie dhe **1** punonjës i P.M.N.Z.SH të arrestuar në flagrancë

### Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

**Vendosur caktimi i masës ndaluese "Arrest në burg"**: 4 punonjës policie, ndërsa 1 ish punonjës policie është shpallur në kërkim

**Vendosur caktimi i masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi"**: 3 punonjës policie

**Vendosur caktimi i masës "Pezullim i ushtrimit të një detyre nga shërbimi publik"**: 9 punonjës policie dhe 3 punonjës i IMT

**Vendosur caktimi i masës së sigurimit personal "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" e**

**"Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik"**: 5 punonjës policie dhe 1 punonjës i AMP

**Vendosur caktimi i masës "Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore"**: 2 punonjës policie

## INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Qershor janë kryer **6 inspektive** të paplanifikuara dhe në 1 rast, për një punonjës policie është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për "Shkelje të lehtë"

**Komisioni Disiplinor** ka shqyrtuar për muajin Qershor në total **29 praktika disiplinore**, nga të cilat në 11 raste ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 24 punonjës policie, ndërsa në 18 raste ka konstatuar dhe vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor, si më poshtë:

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie është vendosur masa "Përfundim nga Policia e Shtetit"

- Në 1 rast, për 2 punonjës policie është vendosur masa "Shtyrje e afatit të gradimit për 2 vite"

- Në 3 raste, për 9 punonjës policie është vendosur masa "Shtyrje e afatit të gradimit për 6 muaj"

- Në 2 raste, për 6 punonjës policie është vendosur përfundimi i hetimit disiplinor pa shkelje administrative

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie është vendosur pezullimi i hetimit disiplinor deri në përfundim të hetimit penal

- Në 3 raste, për 5 punonjës policie është vendosur fillimi i hetimit disiplinor për "Shkelje të rëndë"

- Në 2 raste, për 3 punonjës policie është vendosur mosfillimi i hetimit disiplinor pasi shkelja e disiplinore e kryer nuk është konstatuar nga veprimtaria e AMP dhe për punonjesit e policise ka nisur hetimi disiplinor nga DSP

- Në 4 raste, për 9 punonjës policie, është vendosur mosfillimi i hetimit disiplinor pasi nuk janë konstatuar shkelje administrative

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie është vendosur mosfillimi i hetimit disiplinor, pasi është dhënë masë disiplinore nga DPPSH "Përfundim nga Policia e Shtetit "

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni ka vendosur rekomandimin për "Shkelje të lehtë"

## HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE



Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun

**420 Telefonata**

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat:

**223** telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

**67** telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

**130** telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



## Ankesa të trajtuara

**119 ankesa**

- Në **8** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në **83** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në **28** raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen



## Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

**146 ankesa**